31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, pëmdryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose

b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paga e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paga pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përcqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40

Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 30 % për kohëzgjatjen e periudhës prej 150 diteve .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.

	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <u>120 ditë</u>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parimet përgjithshme e të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga 50000 € për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë" ose kompania e sigurimi Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve 5 vite.
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuuese e defekteve është <u>5 vite</u>


Pagesa shkëputjes kontratës pas së	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore.	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA						
PROJEKTI KRYESOR I RRUGËS: NEKIBE KELMENDI NË PRISHTINË						
Gjatësia L=754m P62-P112						
Nr. rendor	Posicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1	1.0 PUNËT E DEMOLIMIT					
	1.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike për rrugë, trotuare dhe të gjitha objektet ndimëse.	m'	754.00	0.30	226.20
	1.2	Krijimi i hapësirave për qarkullim të pa ndërprer të këmbësorve dhe automjeteve gjatë kohës së zhvillimit të punimeve.	m'	754.00	0.30	226.20
	1.3	Prerja vjore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m'	85.00	1.50	127.50
	1.4	Riparimi i instalimeve egzistuese nëntoksore në rast dëmtimi gjatë punimeve në trase.	m'	754.00	1.00	754.00
	1.5	Demolimi dhe transporti deri në deponi i asfaltit, pllakave nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta	m ²	4,900.00	1.35	6,615.00
	1.6	Demolimi i gurëve skajorë egzistues me dim 18x24 dhe materialeve tjera të ngurta duke përfshir edhe transportin.	m'	55.00	2.00	110.00
	1.7	Demolimi i gurëve skajorë egzistues me dim 10x20 dhe materialeve tjera të ngurta duke përfshir edhe transportin.	m'	55.00	1.50	82.50
	1.8	Demolimi dhe transporti deri në deponi i materialeve të betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m ³	14.50	30.00	435.00
	1.9	Demolimi i gypave egzistues të kanalizimit dhe gypave tjerë egzistues dhe transporti deri në deponi.	m'	450.00	1.00	450.00
	1.10	Demolimi i pusetave të ndryshme egzistuese me thellësi nga H=1.5-3.5m dhe largimi deri në deponi.	copë	8.00	35.00	280.00
	1.11	Demolimi i ujëmbledhësve egzistues dhe largimi deri në deponi.	copë	2.00	25.00	50.00
	1.14	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	orë	25.00	20.00	500.00
	TOTAL PUNËT E DEMOLIMIT :					9,856.40

2

Posicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2.0 PUNËT E DHEUT					
2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V të me ngarkim dhe lartësi deri në deponi në largësi 15km.	m ³	11,355.00	1.80	20,439.00
2.2	Gryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmërisë 25N/mm ²	m ²	8,290.00	0.35	2,901.50
2.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m ²	m ²	8,290.00	1.00	8,290.00
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jo koherent me CBR>20%, shtrirja dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 50MN/m ²	m ³	3,818.00	7.00	26,726.00
2.5	Furnizimi, transporti, punimi i bankinave me lampon.	m ³	115.00	5.00	575.00
2.6	Humusim duke përfshirë: Furnizimi, transporti, planifikimi dhe gëlbrimi i hapësirave gjelbruese duke përfshirë mirmbajtjen një vjeqare.	m ³	80.00	22.00	1,760.00
2.7	Furnizimi, transporti i drurit dekorativ me lartësi h=3.0m, trashësi të trugut dmin=10cm, hapja e gropës me dimensione 80cm x 80 cm - thellësi 100 cm, transporti i dheut në deponi si dhe furnizimi për qdo grupe me 50 litra substrat duke përfshirë mirmbajtjen, ullijen dhe ndërrimin e tij eventual në periudhë 1 vjeqare.	copë	18.00	85.00	1,530.00
PUNIMET E DHEUT					

2,217.50




Posidoni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
3.0 PUNËT E TAMPONIT					
3	3.1 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>60MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-150mm me trashësi të ndryshme (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e trupit të rruges në pikat ku kemi nënbaz të dobët.	m ³	63.00	11.00	693.00
	3.2 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtres rrafshuese nën kocka betoni me t=5cm (në gjendje të ngjeshur).	m ³	115.00	10.00	1,150.00
	3.3 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtres rrafshuese nën kocka betoni me t=5cm (si shtres mbrojtse e gjeotekstilit në gjendje të ngjeshur).	m ³	377.00	9.50	3,581.50
	3.4 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>85MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-63mm me trashësi 40cm në trup të rruges (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e trupit të rruges.	m ³	3,317.00	8.00	26,536.00
	3.5 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>100MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-31.5mm me trashësi t=15 cm në rrugë (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e asfaltit.	m ³	1,244.00	8.00	9,952.00
TOTAL PUNËT E TAMPONIT:					41,912.50



Nr. rendor	Posicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
4		4.0 PUNËT E BETON DHE ASFALTIT				
	4.1	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 18/24 MB40 M100 në shtresë betoni MB20 me pamje ngjyr të bardhë (i përber nga cementi dhe agregati i bardhë) duke përfshir edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngjirje shkëlqej.	m ³	1,510.00	10.00	15,100.00
	4.2	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve B/20 MB40 M100 në shtresë betoni MB20, duke përfshir edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngjirje shkëlqej.	m ³	1,640.00	6.00	9,840.00
	4.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i Pllakave të betonit MB40 dhe trashësi t=80mm dy shtresore (dimenzione: 30x20 dhe 30x30) ose të ngjashme ku shtresa e parë është nga betoni i presuar ndërsa shtresa e dytë nga materialet e grincuara si : Graniti, Kuarci, Diabazi etj me trashësi t=15mm, (trashësia në vlera referuese të standarteve evropiane EN 13748-2. Pllaka për përdorim në hapësira të hapura në ambient të jashtëm. Për të qenë i kualifikuar si material duhet të plotësoj standartet : EC(declaration of conformity). Produkti të posedoj shenjen CE në përputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 për Pllaka të ambienteve të jashtme. Montimi përfshinë edhe mbushjen e fugave me rërë të imët si dhe ngjeshja e tyre. Ngjyra e pllakave dhe dizajni i montimit përcaktohet nga mbikqyrësi në bashkëpunim me projektuesin.	m ²	2,260.00	16.00	36,160.00
	4.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm SMA11, PmB 50/70-65 me përforcues të asfaltit me përberje të fibrave të Aramidit dhe Polyolefineve (ekuivalent me FORTA FI) ose materiale të tjera me përbarje dhe karakteristika të njëjta (500gr/1 ton asfalt) me trashësi t=4,0cm si dhe sterpikjen me emulsion në tërë hapësirën e shiritit të biciklistave.	m ²	260.00	11.00	2,860.00
	4.5	Furnizimi , transporti dhe punimi i shtresës së Asfalt Binderit BA 22, BIT 50/70 me trashësi t=7,0cm si dhe sterpikjen me emulsion në hapësirat e shiritit të biciklistave.	m ²	260.00	10.00	2,600.00
	4.6	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm SMA11 (guri eruptiv) PmB 50/70-65 me përforcues të asfaltit me përberje të fibrave të Aramidit dhe Polyolefineve (ekuivalent me FORTA FI) ose materiale të tjera me përbarje dhe karakteristika të njëjta (500gr/1 ton asfalt) me trashësi t=4,0cm si dhe sterpikjen me emulsion në tërë hapësirën e shiritit të komunikacionit.	m ²	4,800.00	7.50	36,000.00
	7.8	Furnizimi , transporti dhe punimi i shtresës së bitoagregatit: 31CS me BIT 50/70 me trashësi t=9.0cm si dhe sterpikjen me emulsion në hapësirat rrugës.	m ²	4,800.00	10.00	48,000.00
						150,560.00


Nr. rendor	Posicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
5		5.0 SINJALIZIMI VERTIKAL				
	5.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë trekëndëshe me gjatësi të brinjës së trekëndëshit barabrinjëse prej 900 mm.	copë	6.00	90.00	540.00
	5.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë rrethore përfshirë dhe shenjën STOP me diametër 600 mm.	copë	17.00	68.00	1,156.00
	5.3	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkëndore të informimit me dimensione 600x600mm	copë	22.00	65.00	1,430.00
	5.4	Verejtje: Follet e sipërfaqeve retroreflektuese të shenjave të trafikut duhet të punohen në paku të shkallës së dytë retro-reflektuese të tipit High Intensity Grade - HIG.				




		TOTALI SINJALIZIMI VERTIKAL				3,126.00
Titull i rendit	Pozicioni (sipas L. tek)	Ujoll i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësor	Çmimi total EURO
6	6.0 SINJALIZIMI HORIZONTAL					
	G.1	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha të plota (gjeresia 150 mm)	m'	1,308.00	1.70	2,563.60
	G.2	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të ndërprera (3x3x3 m, me gjersa 150 mm)	m'	150.00	1.10	165.00
	G.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të ndërprera (1x1 m, me gjersa 150 mm)	m'	754.00	1.40	1,055.60
	G.4	Furnizimi dhe punimi në rrugë për shenjimin e vendkalimit të këmbësorëve (pjesa e ngjyrosur e rruges)	m ²	222.00	15.00	3,330.00
	G.5	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha të ndërprera, ndërprera, para vendkalimit të këmbësorëve (0.5x0.5 m, me gjersa 0.25 m, vijat e plota tërthore)	m'	62.00	8.00	496.00
	G.6	Furnizimi dhe punimi në rrugë me shigjeta për lëvizje (me gjatësi 5.00 m)	copë	16.00	30.00	480.00
	G.7	Furnizimi dhe punimi në rrugë i shtresës së hollë me ngjyrë të kuqerremt për shenjimin e shtigjeve për biçikleta (Synocryl cycle path 200-350 µm)	m ²	260.00	6.00	1,560.00
	G.8	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të plota me ngjyrë të bardhë për ndarjen e shiritave të shtegut biçikletave (gjeresia 100 mm)	m'	130.00	1.50	195.00
	G.9	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të ndërprera (1x1x1 m, me gjersa 100 mm) me ngjyrë të bardhë për ndarjen e shiritave të shtegut të biçikletave	m'	260.00	1.00	260.00
	G.10	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vendkalimit të shtegut të biçikletave me vija të ndërprera me ngjyrë të bardhë (0.25x0.25 m, me gjersa 0.25 m)	m'	45.00	15.00	675.00
	G.11	Furnizimi dhe punimi në rrugë i shigjetës për lëvizje drejt dhe me simbolin e biçikletave në shiritin e biçikletave, me ngjyrë të bardhë	copë	8.00	45.00	360.00
	Verejtje: Shenjat horizontale duhet të punchen nga masat e perziera plastike dy komponenteshe të ftohshme përberje të grimcave fluoescnte					
	TOTALI SINJALIZIMI HORIZONTAL					11,140.20



PARAMASA DHE PARALLOGARIA PROJEKTI KRYESOR I RRUGËS: NEKIBE KELMENDI NË PRISHTINË		
Gjatësia L=754m		
1.0	PUNËT E DEMOLIMIT	9,856.40
2.0	PUNËT E DHEUT	62,221.50
3.0	PUNËT E TAMPONIT	41,912.50
4.0	PUNËT E BETON DHE ASFALTIT	150,560.00
5.0	SINJALIZIMI VERTIKAL	3,126.00
6.0	SINJALIZIMI HORIZONTAL	11,140.20
Totali:		278,816.60



Paramasa dhe parallogaria për Lëshesën në formë kutije me dimensione: BxH=(3.20x2.12)m					
Nr. R.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
1	Piketimi gjedezik për lëshesën pllakore	paushall	1.00	100.00	100.00
	A.1 - Punët e dheut				0.00
2	Gërmimi i dheut të kategorisë së III-të dhe IV- dhe V me transportim të materialit deri L=10.0 km .	m ³	447.30	5.00	2,236.50
3	Mbushja me zhavor nënë bazën e themelit (gurë të thyer) në shtresë të ngjeshura e trashësi max. h=40 cm	m ³	35.00	11.00	385.00
	A.2 - Betoni dhe armatura për strukturë e lëshesës pllakore				0.00
4	Furnizimi, transportimi dhe vendosja e betonit të thjeshtë për rrafshim para C-12/16	m ³	7.90	50.00	395.00
5	Furnizimi dhe vendosja e betonit për themele C-30/37	m ³	39.45	100.00	3,945.00
6	Furnizimi dhe vendosja e betonit për mure vertikale C-30/37	m ³	40.63	100.00	4,063.00
7	Furnizimi dhe vendosja e betonit për soletë të mbistrukturës C-30/37	m ³	20.92	100.00	2,092.00
8	Furnizimi dhe vendosja e armaturës në strukturat e betonit lloji FeB44K (S-500)	kg	7608.15	1.00	7,608.15
9	Furnizimi dhe instalimi i shtresave për hidroizolim të soletës dhe mureve vertikale deri në mesin e thellësisë së tyre	m ²	132.25	12.00	1,587.00
9	Furnizimi, Transporti dhe punimi i parrakeve nga profilet e zinkuara të tipit B të njëfishta.	m	35.00	37.00	1,295.00
10	Furnizimi, Transporti dhe punimi i parrakeve nga profilet e zinkuara të Çeliku I kualitetit (S500) me vertikale Ø75mm të larta 110cm të cilat vendosen në qdo 2.0m distancë të lidhura me tri breza horizontal nga profili Ø75mm dhe të mbushura me profil vertikal Ø25mm në qdo 10.0cm duke përfshirë lyrjen me dy shtresa ngjyrë dhe parangjyr për ambiente të jashtme dhe material përkatës.	m	21.00	45.00	945.00
11	Rregullimi i rrjedhjes në hyrje dhe dalje të lëshesës pllakore me kalldërm nga guri e vendosur në shtresë rëre t=10cm , me mbushjen e fugeve me llaç çimentoje	m ³	40.00	40.00	1,600.00
TOTALI LËSHESA NË FORMË KUTIE					26,251.65



PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK

• Rruga "Nekibe Kelmendi", Prishtina e Re P62-P112

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT						
1.1		Trasimi-piketimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike sipas projektit, i cili shërben për përcjelljen e punimeve, gjatë ekzekutimit të punimeve të kanalizimit.	m'	754.71	0.50	377.36
1.2		Inçizimi, i rrjetit sipas gjendjes së ekzekutuar të kanalizimit (pas ekzekutimit të rrjetit të kanalizimit). Inçizimi gjeodezik duhet të bëhet nga kompania e licensuar për këtë lloj aktiviteti. Materiali duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	754.71	0.50	377.36
1.3		Pastrimi i terrenit, demolimi i materialeve tjera të ngurta, pustave ekzistuese, gypave të infrastruktures nëntokësore, rrethojave etj., në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit si dhe largimi i ktyre materialeve deri në deponi (aty ku percakton organi mbikëqyres)	paushall	1.00	200.00	200.00
1.4		Demolimi i shtresave egzistuese si asfaltat ose pllaka betoni duke përfshirë prerjen këndore në dy anë si dhe transporti deri në deponi në gjatësi L=15km	m²	110.00	3.00	330.00
1.7		Realizimi i lidhjeve të gypave të kanalizimit atm nga objektet ekzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit, duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	5.00	25.00	125.00
1.8		Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në pusëtën ekzistues duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	1.00	100.00	100.00
1.9		Gërmimi me dorë, makinë, dhe transporti deri në deponi i dheut, me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikëqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tëhet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në H= 3.3m', kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit.				0.00
a		gërmimi me makinë 90%	m³	2174.00	1.50	3261.00
b		gërmimi me dorë 10%	m³	271.00	3.00	813.00
1.7		Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.	m'	754.71	1.50	1132.07
1.1		Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusëtave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 98 pjesa	m³	28.00	10.00	280.00



1.1	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m ²	754.00	1.00	754.00
1.12	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m ³	302.00	10.00	3020.00
1.13	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	754.71	1.00	754.71
1.14	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m ³	1990.00	6.00	11940.00
1.15	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	10.00	25.00	250.00
TOTAL PUNËT E DHEUT :					23,714.49


Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME						
2.1		Përpunimi i fundit të pusëtës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e pllakes nga betoni dhe kinetave sipas detajit në projekt). Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 20cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.				
a		për puseta rrugore	m ³	19.00	70.00	1330.00
2.2		Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për puseten e ujmbledhësave me dim: 60*40cm.	copë	34.00	50.00	1700.00
